



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr \_\_\_\_\_ prot

Gramsh, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

*[Data:13.09.2024]*

Drejtuar: OE "INERTI" SHPK, Nipt J 66926804 L, **Adresa** : Elbasan Gramsh GRAMSH L. SPORTI

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-12742-07-10-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Rikonstruksioni Shkollës 9-vjeçare "Rilindja" Bashkia Gramsh"; Fondi limit : 92,556,705 (nëntëdhjetë e dy milion e pesëqindë e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqindë e pesë) lekë pa TVSH, Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 8 muaj nga fillimi i punimeve (dorëzimi sheshit të punimeve).

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): JO

Buletini i Njoftimeve Publike [Data:15.07.2024] [Numri:37]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **OE** -“ Z D R A V A ”sh.p.k - **Nipt** - J 84003411 K - **Vlera**- 91,632,137.2 (nentedhjetë e nje milion e gjashteqind e tridhjetë e dy mije e njeqind e tridhjetë e shtate pikë 2) lekë,pa TVSH
2. **BOE** - “BEQIRI” SHPK, **Nipt** J 98624801 V & “C O L O M B O” SHPK, **Nipt** J 82916489 E - **Vlera**- 76,552,633 (shtatedhjetë e gjashte milion e peseqind e pesedhjetë e dy mije e gjashte qind e tridhjetë e tre) lekë,pa TVSH
3. **OE** – “ ASI-2A CO” sh.p.k - **Nipt** - K 53002402 C - **Vlera** - 75,856,621.15 (shtatedhjetë e pese milion e teteqind e pesedhjetë e gjashte mije e gjashteqind e njezete e nje pike 15) lekë,pa TVSH
4. **OE** –“INERTI”sh.p.k - **Nipt** - J 66926804 L - **Vlera**- 87,923,313.2 ( tetedhjetë e shtate milion e nenteqind e njezete e tre mije e treqind e trembedhjetë pike 2) lekë,pa TVSH
5. **OE** – “ RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN ” sh.p.k - **Nipt** - J 62904264 O - **Vlera**- 90,707,197.2 ( nentedhjetë milion e shtateqind e shtate mije e njeqind e nentedhjetë e shtate pike 2) lekë,pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

### **1. Operatori ekonomik –“ Z D R A V A ” sh.p.k**

Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.2.1 është kërkuar:

”Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore 3 (tri) viteve të fundit financiare lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë sa vlera e përlllogaritur e fondit limit që prokurohet.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Operatori ekonomik “Z D R A V A” shpk nuk ka dorëzuar vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare në kundërshtim me pikën 2.2.1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit .

Në Seksionin 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike të DST-së është kërkuar :

3.1 Sigurimi i ofertës: *(e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).*

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës (2% e fondit limit) është 1,851,134 (nje milion e teteqinde e pesedhjetë e nje mije e njeqinde e tridhjetë e kater) lekë.

Operatori ekonomik “Z D R A V A” shpk nuk ka dorëzuar Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3 në kundërshtim me pikën 1/b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit .

Në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar:

2.3.2.1 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë *(nga Administratori i shoqërisë ) Drejtuesin Teknik* të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera (të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt), *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

Operatori ekonomik “Z D R A V A” shpk nuk ka dorëzuar deklaratën për drejtuesin teknik si më sipër , në kundërshtim me pikën 2.3.2.1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit

Në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar:

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libeze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 1(një) Inxhinier Ndërtimi
- Minimuni 1(një) Inxhinier Elektrik
- Minimuni 1(një) Inxhinier Elektronik
- Minimuni 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- Minimuni 1 (një) Inxhinier Mekanik

Operatori ekonomik “Z D R A V A” shpk nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit që disponon një inxhinier elektronik në kundërshtim me pikën 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit

Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.5 është kërkuar:

2.3.5. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Teknik hidraulik– jo më pak se 1 (një) punonjës
- Teknik mekanik – jo më pak se 1 (një) punonjës
- Teknik elektrik – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Teknik gjeodez/topograf – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Teknik perpunim druri – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Murator – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Mekanik – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Hidraulik – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Elektriçist – jo më pak se 3 (tre) punonjës
- Punonjes Saldator – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Bojaxhi – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Karpentier – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Hidroizolues – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Pllakashtrues – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Dyer/Dritare – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Specialist Kaldaje – jo më pak se 2 (dy) punonjës
- Punonjes Gipsi – jo më pak se 2 (dy) punonjës

Operatori ekonomik “Z D R A V A” shpk nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit 1(një) teknik ndërtimi, 1(një) teknik topograf, 1(një) teknik topograf, 1(një) teknik hidraulik, 1(një) teknik mekanik, 2(dy) teknik elektrik, 2(dy) teknik perpunim druri, 2(dy) muratorë, 2(dy) punonjës dyer/dritare, 2(dy) specialist kaldaje , 2(dy) punonjës gipsi , në kundërshtim me pikën 2.3.5 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit

Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.6 është kërkuar:

2.3.6 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Manovrator 2 (dy);
- Automakinist 2 (dy).

Operatori ekonomik “Z D R A V A” shpk nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit 1(një) manovrator dhe 2(dy) automakinistë në kundërshtim me pikën 2.3.6 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit

Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.13 është kërkuar:

2.3.13. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën –Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit(QKL), të vlefshme.

Operatori ekonomik “Z D R A V A” shpk nuk ka dorëzuar në SPE licencën–Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit(QKL) në kundërshtim me pikën 2.3.13 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit

Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.15 është kërkuar:

2.3.15 Operatori ekonomik ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar ne DST, duhet të paraqesë autorizim/kontrate/marveshje bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë si më poshtë:

- a) Hekur
- b) Materiale Hidraulike
- c) Paisje Ngrohje
- d) Materiale Elektrike

Operatori ekonomik “Z D R A V A” shpk nuk ka dorëzuar në SPE autorizim / kontrate / marveshje bashkepunimi nga prodhuesi / distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender , për materialet hekur, materiale hidraulike, pajisje ngrohje dhe materiale elektrike në kundërshtim me pikën 2.3.15 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.16 është kërkuar:

2.3.16 Operatorët ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-7:2019, SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019.

Operatori ekonomik “Z D R A V A” shpk nuk ka dorëzuar në SPE kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-7:2019, SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019, në kundërshtim me pikën 2.3.16 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

## **2.Operatori ekonomik –“ RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN ”sh.p.k**

Në kriteret e vecanta të kualifikimit në pikën 2.3.2 është kërkuar licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë ndër të tjera edhe kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës: N.P-12 C, NS-12 B.

Operatori ekonomik “ RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN ” sh.p.k, nuk disponon kategoritë e mësipërme të licencës , por disponon kategoritë NP-12A dhe NS -12A në kundërshtim me pikën 2.3.2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN ”sh.p.k, nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit 1(një) inxhinier elektronik,1(një) inxhinier hidroteknik, 1(një) teknik ndërtimi, 1(një) teknik hidraulik, 1(një) teknik mekanik, 2(dy)

teknik elektrik, 2(dy) teknik gjeodet / topograf, 2(dy) teknik përpunim druri, 2(dy) muratorë, 2(dy) mekanikë, 2(dy) hidraulikë, 2(dy) elektrikistë, 2(dy) saldatorë, 2(dy) bojaxhij, 2(dy) karpentierë, 2(dy) hidroizolues, 2(dy) pllakashtrues, 2(dy) punonjës dyer/dritare, 2(dy) specialist kaldaje, 2(dy) punonjës gipsi, 2(dy) automakinistë në kundërshtim me pikën 2.3.5 dhe 2.3.6 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.p.k” shpk nuk ka dorëzuar Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3 në kundërshtim me pikën 1/b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit .

Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.p.k, nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit 1(një) mjek të përgjithshëm, 1(një) ekspert zjarrfikës, në kundërshtim me pikën 2.3.7 dhe 2.3.8 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.p.k, nuk ka plotësuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Deklaratën për disponimin e mjeteve/ pajisjeve/ makinerive për realizimin e punimeve objekt kontrate”, duke mos provuar kështu të ketë në pronësi apo me qira asnjë nga mjetet/ pajisjet/ makineritë e përcaktuara në pikën 2.3.11 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.p.k nuk ka dorëzuar deklaratën për drejtuesin teknik, në kundërshtim me pikën 2.3.2.1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.p.k nuk ka dorëzuar në SPE Certifikata ISO 3834 - 1:2021 (Për Kërkesat e Cilësisë për Saldim me Shkrije të Materialeve Metalike(e vlefshme), lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Çertifikatën e menaxhimit të energjisë si dhe ISO 50001-2018 (e vlefshme), lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim, në kundërshtim me pikën 2.3.12 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit

Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.p.k nuk ka dorëzuar në SPE liçencën–Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit(QKL) në kundërshtim me pikën 2.3.13 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit

Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.p.k nuk ka dorëzuar në SPE autorizim/kontrate/marveshje bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender , për materialet hekur, materiale hidraulike, pajisje ngrohje dhe materiale elektrike në kundërshtim me pikën 2.3.15 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Operatori ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.p.k nuk ka dorëzuar në SPE kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-7:2019, SSH EN 12350-2:2019, SSH EN 12504-2:2021, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019, në kundërshtim me pikën 2.3.16 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

### **3.Operatori ekonomik – “ASI-2A CO” sh.p.k**

-Në Dokumentat Standarde të Tenderit në Shtojcën 7 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit “, në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit” është parashikuar : “Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”. Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

-Shtojca 8 “**Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit**”parashikon se “ Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”.

Operatori ekonomik – “ASI-2A CO” sh.p.k në Formularin përmbledhës i vetëdeklarimit në Deklaratën B”,ka deklaruar se mbështetet në kapacitetet e operatorit ekonomik “Varaku E” sh.p.k , konkretisht për 40 punonjës të thjeshtë, por subjekti mbështetës nuk ka dorëzuar Formular të veçantë të Vetëdeklarimit si dhe nuk nja angazhim me shkrim të operatorit ekonomik ofertues “ASI-2A CO” sh.p.k dhe subjektit mbështetës “Varaku E” sh.p.k, në kundërshtim me kriteret e përgjithshme të kualifikimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Fshati Mashan, Njësia Administrative Kodovjat, Bashkia Gramsh”, KVO konstatoi se një pjesë e konsiderueshme e mjeteve/pajisjetve/makineritve dhe stafit teknik të Operatori ekonomik – “ASI-2A CO” sh.p.k janë të angazhuara në një kontratë tjetër lidhur midis bashkisë Librazhd dhe OE “ASI-2A CO” shpk .

Nga verifikimi i informacionit të deklaruar ne Formularin përmbledhës i vetëdeklarimit në procedurën objekt vlerësimi “Rikonstruksioni Shkollës 9-vjeçare "Rilindja" Bashkia Gramsh” , me informacionin e deklaruar në Formularin përmbledhës i vetëdeklarimit, në procedurën për të cilën është lidhur kontrata në proces , konstatohet se operatori ekonomik “ASI-2A CO” shpk, nuk përmbush kriteret për stafin teknik dhe punonjësit e kualifikuar si më poshtë : 1(një) ing.ndërtimi, 1(një) ing.hidroteknik, 1(një) ing.mekanik, 1(një) ekspet zjarrfikës, 2(dy) teknikë ndërtimi, 1(një) teknik hidraulik,2(dy) teknikë topografë, 2(dy) teknikë përpunim druri, 1(një) murator, 2(dy)mekanikë, 1(një) hidraulik, 2(dy) karpentierë, 1(një) automakinist, 2(dy) manovratorë , pasi të gjithë këta specialistë janë të deklaruar dhe angazhuar në kontratën me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Librazhd Katund, faza e I- rë,Njësia Administrative Qendër,Bashkia Librazhd”.

Gjithashtu operatori ekonomik “ASI-2A CO”shpk, nuk përmbush kriteret për mjetet / pajisjet / makineritë si më poshtë:

1(një) Eskavator me goma, 1(një) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, 1(një) Autobetoniere, 1(një) Kamion me Vinc, 1(një) Fadrome me kove para dhe kove mbrapa, 1(një) Autobot Uji, pasi të gjithë këto mjete/pajisje/makineri janë të deklaruar dhe angazhuar në kontratën me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Librazhd Katund, faza e I- rë,Njësia Administrative Qendër,Bashkia Librazhd”.

Si përfundim, OE “ASI-2A CO”shpk nuk përmbush kriteret lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kërkuar në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të përshkruara në DST .

#### **4.BOE- “BEQIRI ” sh.p.k & “C O L O M B O” sh.p.k**

KVO konstaton se oferta e BOE- “BEQIRI” sh.p.k & “C O L O M B O” sh.p.k **ka gabime aritmetike**,Gabimet e ofertës së BOE- “BEQIRI ” sh.p.k & “C O L O M B O” sh.p.k , konsistojnë: Në kapitullin 6.Punime fasade , nr.rendor 4, nr.analize 4.1 “F.V Konstruksione metalike te perbera per shkalle emergjence”, prodhimi që del nga shumëzimi i sasisë dhe çmimit për njësi është përlllogaritur gabim.

Nga përlllogaritjet e BOE rezulton  $4 \times 270\,000 = 1\,080\,000$ , ndërsa në fakt dhe sipas përlllogaritjeve të KVO-së rezulton  $4 \times 270\,000 = 1\,026\,000$ , që do të thotë 54 000 lekë më shumë se oferta e paraqitur..

Po kështu edhe shuma përfundimtare e nëntotaleve pas korigjimit rezulton 74 376 945 lekë (54 000 lekë më shumë).Fondi rezervë pas korigjimit rezulton  $74\,376\,945 \times 3\% = 2\,231\,308$  lekë, vlera përfundimtare e ofertës pas korigjimit rezulton 76 608 253 lekë , pa TVSH dhe 91 929 904 lekë, me TVSH, që do të thotë 55 620 lekë,pa TVSH më shumë se oferta dorëzuar dhe 66 744 lekë,me TVSH, më shumë se oferta e paraqitur nga BOE- “BEQIRI” sh.p.k & “C O L O M B O” sh.p.k .

Legjislacioni për prokurimet publike në këtë rast parashikon se :

Në nenin 92/2 të LPP parashikohet se “*Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet*”.

Në nenin 82 pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik,*(i ndryshuar)*,parashikohet se ;

Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.
- b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.
- c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, **por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.**

Në Seksionin I: “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë” Kapitulli F “Vlerësimi i Ofertave “, pika 22 parashikohet se :

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

-Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.

-Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.

-Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.

-Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, **por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.**

Sipas përlllogaritjeve të KVO-së shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

Për sa më sipër, në rrugë elektronike më datë 23.08.2024 i dërgohet BOE- “BEQIRI ” sh.p.k & “C O L O M B O ” sh.p.k “Kërkesë për pranimin e korrigjimit të gabimeve aritmetike”, duke i lënë afat 5 ditë pune nga njoftimi , për pranimin ose jo të korrigjimeve aritmetike. Afati përfundimtar i kthimit të përgjigjes nga BOE “BEQIRI ” sh.p.k & “C O L O M B O ”

sh.p.k, ka qenë më datë 29.08.2024 ora 16.00 dhe deri më datë 02.09.2024 nuk është kthyer përgjigje pranë Autoritetit Kontraktor as në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe as në rrugë shkresore.

Për këtë arsye, KVO me unanimitet vendosi të skualifikojë ofertën e BOE “BEQIRI ” sh.p.k & “C O L O M B O” sh.p.k.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “INERTI” SHPK, Nipt J 66926804 L, **Adresa** : Elbasan Gramsh GRAMSH L. SPORTI se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 87,923,313.2 ( tetedhjetë e shtatë milion e nentëqind e njetëzete e tre mijë e treqind e trembedhjetë pike 2) lekë,pa TVSH është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**ZYRTARI I AUTORIZUAR  
N/KRYETARI I BASHKISË**  
Tajar BICI

*Konceptoi: E.Shahini*

*Pranoi: E.Shahini*

*Miratoi:*

*Konfirmoi:*

*Dosja nr: \_\_\_\_\_*

*Afati i ruajtjes: \_\_\_\_\_*